

**RAPORT TEKNIK
PËR VLERËSIMIN ENDIKIMIT NË MJEDIS
TË PROJEKT ZBATIMIT
“NDËRTIM URE MBI PËRROIN E UNGREJ”
NJËSIA ADMINISTRATIVE UNGREJ
BASHKIA LEZHË**

Pergatitur nga

Studioja “ZENIT & CO” shpk

Eksperti i Mjedisit Yzeir Miraka

Ing mjedisi Elio Mehmeti

TIRANË 2024

PËRMBAJTJA	2
a) Qëllimin e projektit të propozuar;	3
b) Planimetrinë e vendndodhjes së projektit, ku të pasqyrohen në hartë topografike kufijtë e sipërfaqes, të shoqëruar me koordinatat, sipas sistemit koordinativ GAUS KRUGE, fotografi dhe të dhëna për përdorimin ekzistues të sipërfaqes që do të përdoret përkohësisht apo përherë nga projekti, gjatë fazës së ndërtimit apo funksionimit të veprimtarisë;	3
c) Informacionin për qendrat e banuara, në zonën ku propozohet të zbatohet projekti, shoqëruar me fotografi dhe të dhëna për distancën e tyre nga vendndodhja e projektit të propozuar, si dhe përcaktimin e njësisë së qeverisjes vendore që administron territorin ku propozohet projekti;	5
ç) Skicat dhe planimetritë e objekteve dhe strukturave të projektin, si dhe mënyrat dhe metodat që do të përdoren për ndërtimin e objekteve dhe strukturave të projektit;	6
d) Përshkrimin e proceseve ndërtimore dhe teknologjike, përfshirë kapacitetet prodhuese /përpunuese, sasitë e lëndëve të para dhe produktet përfundimtare të projektit;	7
dh) Informacionin për infrastrukturën e nevojshme për lidhjen me rrjetin elektrik, furnizimin me ujë, shkarkimet e ujërave të ndotura dhe mbetjeve, si dhe informacionin për rrugët ekzistuese të aksesit apo nevojën për hapje të rrugëve të reja;	8
e) Programin për ndërtimin, kohëzgjatjen e ndërtimit, kohëzgjatjen e planifikuar për funksionimin e projektit, kohën e mundshme të përfundimit të funksionimit të projektit dhe, sipas rastit, edhe fazën e planifikuar të rehabilitimit të sipërfaqes, pas mbarimit të funksionimit të projektit;	8
ë) Lëndët e para që do të përdoren për ndërtimin dhe mënyra e sigurimit të tyre (materiale ndërtimi, ujë dhe energji);	8
f) Informacionin për lidhjet e mundshme të projektit me projekte të tjera ekzistuese përreth/pranë zonës së projektit;	11
g) Informacionin për alternativat e marra në konsideratë, për sa i takon përzgjedhjes së vendndodhjes së projektit dhe teknologjisë që do të përdoret;	12
gj) të dhënat për përdorimin e lëndëve të para gjatë funksionimit, përfshirë sasitë e ujit të nevojshëm, të energjisë, lëndëve djegëse dhe mënyrën e sigurimit të tyre;	12
h) Aktivitete të tjera që mund të nevojiten për zbatimin e projektit, si ndërtimi i kampeve apo rezidencave etj.;	12
i)Informacionin për lejet, autorizimet dhe licencat e nevojshme për projektin, në përputhje me përcaktimet e bëra në legjislacionin në fuqi, si dhe institucionet kompetente për lejimin / autorizimin/ licencimin e projektit;	12
j)Kopje të lejeve, autorizimeve dhe licencave që disponon zhvilluesi për projektin e propozuar, në përputhje me përcaktimet e bëra në legjislacionin në fuqi, si dhe institucionet kompetente për lejimin / autorizimin/licencimin e projektit	13

Hyrje

Ky projekt është hartuar për të ndërtuar një urë në perroi të Ungrejt në fshatin Ungrej e cila do të shërbejë për lëvizjen e mjeteve dhe njerezve, me kafshet e punës në të dy anët e brigjeve të perroit. Klasifikimi I projektit sipas Ligjit 10440 datë 07/07/2011 (I ndryshuar) klasifikohet.

10. Prodhime infrastrukturore.

b) Projekte për zhvillime urbane, duke përfshirë dhe ndërtimin e qendrave tregtare dhe parkimet për makinat;

Procedura e ndjekur, referuar vendimit Nr. 686, datë 29.7.2015 “Për miratimin e rregullave, të përgjegjësive e të afateve për zhvillimin e procedurës së vlerësimit të ndikimit në mjedis (VNM) dhe procedurës së transferimit të tenderimit e Deklaratës Mjedisore” të ndryshuar, Kreu 10 pika b.

a) Qëllimin e projektit të propozuar;

Projekti i hartuar nga bashkia Lezhe. Qëllimi i veprimtarisë është bërë për të ndërtuar një urë në perroi të Ungrejt e cila do të shërbejë për lëvizjen e mjeteve dhe njerezve me kafshet e punës nga të dy anët e perroit. Kjo veprimtari bën pjesë në listën e veprimtarive që i nënshtrohen procedurave për tu pajisur me vnm paraprake referuar Ligjit Nr. 10 440, datë 7.7.2011 “Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis” i ndryshuar dhe Ligjit Nr. 10 448, datë 14.7.2011 “Për Lejet e Mjedisit” të ndryshuar. Sipas shtojcës nr. 2 klasifikohen:

10. Prodhime infrastrukturore.

a) Projekte për zhvillime urbane, duke përfshirë dhe ndërtimin e qendrave tregtare dhe parkimet për makinat;

b) Planimetrinë e vendndodhjes së projektit, ku të pasqyrohen në hartë topografike kufijtë e sipërfaqes, të shoqëruar me koordinatat, sipas sistemit koordinativ GAUS KRUGE, fotografi dhe të dhëna për përdorimin ekzistues të sipërfaqes që do të përdoret përkohësisht apo përherë nga projekti, gjatë fazës së ndërtimit apo funksionimit të veprimtarisë.



Ura ne perroin e Ungrejt


Tabela e kordinatave te ures

	Kordinatat ne KRGJSH		Kordinatat ne Gaus-Krygen		Z
	Y	X	Y	X	
Pika 1	486275.767	4636511.196	4403372456	4637299.525	183
Pika 2	486300.406	4636527.996	4403403.295	4637302.850	183

Siperfaqja qe preket nga projekti eshte rreth 130 m²

c) Informacionin për qendrat e banuara, në zonën ku propozohet të zbatohet projekti, shoqëruar me fotografi dhe të dhëna për distancën e tyre nga vendndodhja e projektit të propozuar, si dhe përcaktimin e njësisë së qeverisjes vendore që administrojnë territorin ku propozohet projekti;

Qendra e banuar në krahun e djathtë të rrëzit të Ungrejt janë shtëpi banimi të cilave do t'u shërbejë ura që do të ndërtohet. Pozicioni i urës është nga 110 m deri 322 m



Distanca nga sheshi ndërtimit të urës është rreth 110m në afërsi të shtëpive të fshatit Kaluar
Sipërfaqja e urës është rreth 130 m²

ç) Skicat dhe planimetritë e objekteve dhe strukturave të projektin, si dhe mënyrat dhe metodat që do të përdoren për ndërtimin e objekteve dhe strukturave të projektit;

- Skicat dhe planimetrit e projektit dhe strukturat e tij;



- **Mënyrat që do të përdoren për ndërtimin e objekteve dhe strukturave të projektit;**
 - ✓ Menyra e ndërtimit të objekteve –konsiston në hartimin e skicave dhe planimetrive të nevojshëm për zberthimin e projektit çdo detaj.
 - ✓ Piktimi I saktë I tyre në sheshin e ndërtimit
 - ✓ Germimin e themeleve
 - ✓ Ndërtimin e strukturave të njëpasnjëshme të projektit
 - ✓ Përgatitja e çdo detaje të ngritjes së armatës për derdhjen e betoneve për ngritjen e strukturës
- **Metodat që do të përdoren për ndërtimin e objekteve dhe strukturave të projektit;**

Metoda e ndërtimit të objekteve dhe strukturave që kërkohen konsistojnë

 - Ngritjen e kantjerit
 - Piktimit topografik të objekteve nga inxh. Topograf
 - Hapjen e themeleve ku do të ngrihen strukturat prej betoni të armuar
 - Mbushja e themeleve deri në arritjen e xoklatës
 - Ngritja e kallupimeve
 - Vendosja të hekurit dhe lidhjen e tij
 - Derdhjen e betoneve sipas markave të kerkuara në projekt
 - Ngritje e skelaturave

d) Përshkrimin e proceseve ndërtimore dhe teknologjike, përfshirë kapacitetet prodhuese /përpunuese, sasi të lëndëve të para dhe produktet përfundimtare të projektit;

- **Përshkrimi I procesit ndërtimor**

Procesi ndërtimor konsiston që në ngritjen e brigadave të specializuara për kryerjen e punimeve – sic janë: Brigadë e përgatitjes së sheshit ku hyjnë, pastrimi I sheshit të ndërtimit
 Procesi ndërtimor do të bëhet sipas specifikimeve si më poshtë :

- 1) **Betoni**

Soletonet janë projektuar me beton c25/30 (m300).

Shpatullat dhe pila e urre, me beton c20/25 (m250).

Trotuari monolit me beton c25/30 (m300).

Betoni i monolitizimit të njëjës lidhës (fuges) të dy soletoneve fqinje dhe shtresës mbrojtëse mbi soletone është me beton c25/30.

- 2) **Hekuri**

Armatura e hekurit për soletonin, shpatullat, pilen është s500.

- 3) **Katramaja dhe bitumi**

Soletonet në jasteke, mbështeten mbi tre shtresa katrama me d=4mm të ngjitura me ngrohje.

- **Proceset teknologjike,**

Germim - betonim - ndërtim ure

- **Kapacitetet prodhuese /përpunuese,**

Ndërtimi për një periudhë 6 mujore me çelës në dorë

- **Sasi të lëndëve të para**

Sasi të lëndëve të para – jepen në preventivin e punimeve

- **Produktet përfundimtare të projektit**

Produkti përfundimtar I projektit është :

- Ndërtimi I urre mbi perroi të Ungrej

dh) Informacionin për infrastrukturën e nevojshme për lidhjen me rrjetin elektrik, furnizimin me ujë, shkarkimet e ujërave të ndotura dhe mbetjeve, si dhe informacionin për rrugët ekzistuese të aksesit apo nevojën për hapje të rrugëve të reja;

- Lidhja me rrjetin elektrik
- Sigurimi I energjise elektrike do te behet me nje gjenerator
- Furnizimi me uji
- Furnizimi me uji te pishem do te behet nepermjet blerjes ne supermarketin me te afert
- Shkarkimi I ujrave te ndotura

Nuk ka .

- Mbetjet
- Mbetjet nga ndertimet do te transportohen nga kompania qe kryen punimet per ne landfillin e caktuar nga bashkia

- Informacion mbi rruget egzistuese dhe nevoja per te hapur rruge te reja
- Rruget egzistuese jane te hapura -nuk ka nevoj per rruge te reja

e) Programin për ndërtimin, kohëzgjatjen e ndërtimit, kohëzgjatjen e planifikuar për funksionimin e projektit, kohën e mundshme të përfundimit të funksionimit të projektit dhe, sipas rastit, edhe fazën e planifikuar të rehabilitimit të sipërfaqes, pas mbarimit të funksionimit të projektit;

- **Programin për ndërtimin**
- Sipas afatit te caktuar nga bashkia Lezhe mbas tenderimit te projektit
- **Kohëzgjatjen e ndërtimit**
- Periudha e ndertimit dhe rikonstruksionit 6 muaj nga lidhja e kontrates me firmen fituese

- **Kohëzgjatjen e planifikuar për funksionimin e projektit**
- E perhershme me nderhyrje here pas here ne pjeset qe amortizohen

- **Kohën e mundshme të përfundimit të funksionimit të projektit - I perjeteshem**
- **Fazën e planifikuar të rehabilitimit të sipërfaqes, pas mbarimit të funksionimit të projektit;**

Sipas nevojave te shoqerise reabilitim apo ndertim te ri ne siperfaqen

ë) Lëndët e para që do të përdoren për ndërtimin dhe mënyra e sigurimit të tyre (materiale ndërtimi, ujë dhe energji);

Në fazën e parë ate të përgatitjes së objektit te sherbimeve- ure , lëndët e para janë :

Çimento

a. Çimento Portland e Zakonshme do te perdoret me BS 12 ose ASTM C-150 Tipi II-te ose Tipi V-te. Kjo do te perdoret aty ku betoni nuk eshte ne kontakt me ujerat e zeza, tub gazi ose ujerat nentokesore.

b. Çimento Portland Sulfate e Rezistueshme do te perdoret me BS 4027. Kjo do te perdoret per strukturat e betoneve duke perfshire pusetat dhe te gjitha perkatesite e tjera ne kontakt me ujerat e zeza, tubin e ujrave termal ose ujerat nentokesore. Çimento duhet te shperndahet ne paketa origjinale te shenuara te pa demtuara direkt nga fabrika dhe duhet te ruhet ne nje depo, dyshemeja e te cilit duhet te jete e ngritur te pakten 150mm nga toka. Nje sasi e mjaftueshme duhet mbajtur rezerve per te siguruar nje furnizim te vazhdueshem ne pune, ne menyre qe te sigurohet qe dergesat e ndryshme jane perdorur ne ate menyre sic jane shperndare. Çimentoja nuk duhet ruajtur ne kantier per me shume se tre muaj pa lejen e Mbikqyresit te Punimeve. Çdo lloj tjetër cimento, pervec asaj qe eshte e parashikuar per perdorimin ne pune nuk duhet ruajtur ne depo te tilla. E gjithë cimentoja duhet mbajtur e ajrosur mire dhe cdo lloj cimento, e cila ka filluar te ngurtesohet, ose ndryshe e demtuar apo e keqesuar nuk duhet te perdoret. Fletet e analizave te fabrikave duhet te shoqerojne cdo dergese duke vertetuar qe cimentoja, e cila shperndahet ne kantjerin e ndertimit ka qene e testuar dhe i ka plotesuar kerkesat e permendura me lart. Me te mberitur, certifikatat e provave te tilla duhen ti kalohen per t'i aprovuar Mbikqyresit te Punimeve. Çimentoja e perfituar nga pastrimi i thaseve te çimentos ose nga pastrimi i dyshemese nuk do te perdoret. Kur udhezohet nga Mbikqyresi i Punimeve, çimento e dyshimte duhet te ritestohet per humbjen e fortesise ne ngjeshje.

Inertet

Me perjashtim te asaj qe eshte modifikuar ketu, inertet (te imta dhe te trasha) per te gjitha tipet e betonit duhet te perdoren duke respektuar STASH-512-78 (Standarti Shqiptar) ose ne perputhje me ASTM C 33 “**Inertet e betonit nga burime natyrale**”. Ato duhet te jene te forte dhe te qendrueshem dhe nuk duhet te permbajne materiale te demshme qe veprojne kunder fortesise ose qendrueshmerise se betonit ose, ne rast te betonarmese mund te shkaterroje kte perforcim. Materialet e perdorura si inerte duhet te perftohen nga burimet te njohura per te arritur rezultate te kenaqshme per klasa te ndryshme te betonit. Nuk do te lejohet perdorimi i inerteve nga burime, te cilat nuk jane te aprovuara nga Mbikqyresi i Punimeve. Inertet e imta Inertet e imta per kategorite e betonit A, B dhe C (respektivisht M100, M200, M250) konform STASH 512-78, do te jene prej rere natyrale, gure te shoshitur, ose materiale te tjera inerte me te njejtat karakteristika apo kombinim te tyre. E gjitha kjo duhet te jete pastruar shume mire, pa masa te mpiksura, cifla te buta e te vecanta, vajra distilimi, alkale, lende organike, argjile dhe sasi te substancave te demtuese. Permbajtja maksimale e lejueshme e lymit dhe substancave te tjera demtuese eshte 5%. Materialet e marra nga gure te papershtashem per inerte te trasha nuk duhet te perdoren si inerte te imta. Inertet e imta te marra nga guret e shoshitur duhet te jene te mprehte, kubike, te forte, te dendur dhe te durueshem dhe duhet te grumbullohen ne nje platforme per te patur nje mbrojtje te mjaftueshme nga pluhurat dhe perzierjet e tjera. Shkalla e shperndarjes per inertet e imeta te specifikuara si me lart, duhet te jene brenda kufijve te meposhtem, te percaktuara nga Mbikqyresi i Punimeve

Masa e Sites	Perqindja qe kalon (peshe e thate)
10.00mm	100
5.00mm	89 ne 100
2.36mm	60 ne 100
1.18mm	30 ne 100
0.60mm (600 um)	15 ne 100

0.30mm (300 um)	5 ne 70
0.15mm (150 um)	0 ne 15

Inerttet e imeta per kategorine D te betonit duhet te jene te nje cilesie te mire nga rera e brigjeve. Ajo duhet te jete pastruar nga materialet natyrale e klasifikuar nga me e holla deri tek me e trasha, pa copeza, nga argjila, zgjyra, hirera, plehra dhe cifla te tjera. Nuk duhet te permbaje me shume se 10% te materialit me te holle se 0.10mm (100um) te hapesires ne rrjete, jo me shume se 5% te pjeses se mbetur ne 2.36mm site; i gjithë materiali duhet te kaloje neper nje rrjete 10mm. Inerttet e trasha Inerttet e trasha per kategorite e betonit A, B dhe C do te perbehen nga materiale guri te thyer apo te nxjere ose nje kombinim i tyre, me nje mase jo me shume se 20 mm, dhe do te jene te paster, te forte, te qendrueshem, kubik dhe te formuar mire, pa lende te buta apo te thermueshme, ose copeza te holla te stergjatura, alkale, lende organike ose masa apo substanca te tjera te demshme. Lendet demtuese ne inerte nuk duhet te kalojne me shume se 3 %. Klasifikimi per inerttet e trasha te specifikuara sa me siper duhet te jete brenda kufijve te meposhtem:

Masa e sites	Perqindja e kalimit (ne peshe te thate)
50.0 mm	100
37.5 mm	90 ne 100
20.0 mm	35 ne 70
10.0 mm	10 ne 40
5.0 mm	0 ne 5

Inerttet e trasha per kategorine D te betonit duhet te jene tulla te thyera te prodhuara prej tullave te cilesise se pare ose grumbulli i tyre, ose nga tulla te mbipjekura. Nuk do te thyhen per perdorim per inerte te imta as tullat e papjekura apo grumbulli i tyre dhe as ato qe jane bere porose gjate procesit te pjekjes. Agregati me tulla te thyera nuk duhet te permbaje gjethe, kashte dhe, rere ose materiale te tjera te huaja dhe ose mbeturina te tjera. Inerttet prej tullave te thyera duhet te jene te nje diametri 25-40 mm dhe nuk duhet te permbajne asgje qe te kaloje nepermjet sites 2.36 mm. site; i gjithë materiali duhet te kaloje neper nje rrjete 10mm.

Inerttet e trasha

Inerttet e trasha per kategorite e betonit A, B dhe C do te perbehen nga materiale guri te thyer apo te nxjere ose nje kombinim i tyre, me nje mase jo me shume se 20 mm, dhe do te jene te paster, te forte, te qendrueshem, kubik dhe te formuar mire, pa lende te buta apo te thermueshme, ose copeza te holla te stergjatura, alkale, lende organike ose masa apo substanca te tjera te demshme. Lendet demtuese ne inerte nuk duhet te kalojne me shume se 3 %. Klasifikimi per inerttet e trasha te specifikuara sa me siper duhet te jete brenda kufijve te meposhtem:

Masa e sites	Perqindja e kalimit (ne peshe te thate)
50.0 mm	100
37.5 mm	90 ne 100
20.0 mm	35 ne 70
10.0 mm	10 ne 40
5.0 mm	0 ne 5

Inertet e trasha per kategorine D te betonit duhet te jene tulla te thyera te prodhuara prej tullave te cilesise se pare ose grumbulli i tyre, ose nga tulla te mbipjekura. Nuk do te thyhen per perdorim per inerte te imta as tullat e papjekura apo grumbulli i tyre dhe as ato qe jane bere porose gjate procesit te pjekjes. Agregati me tulla te thyera nuk duhet te permbaje gjethe, kashte dhe, rere ose materiale te tjera te huaja dhe ose mbeturina te tjera. Inertet prej tullave te thyera duhet te jene te nje diametri 25-40 mm dhe nuk duhet te permbajne asgje qe te kaloje nepermjet sites 2.36 mm.

- **Llaçe** ndërtimi shërbejnë për fiksimin e gurëve në muraturë, për suvatimin e mureve, tavaneve etj. (shih.), si dhe për prodhimin e pjesëve të ndërtimit (pllaka, blloqe).
- **Lidhës përdoret** në prodhimin e llaçeve dhe betoneve .Ato ndahen në minerale (çimento, gëlqere, etj.) dhe organike (bitum, katran). Lidhësit minerale ndahen, nga ana tjetër, në ajër (gëlqere ajri, gips, argjilë), që forcohen vetëm në ajër, dhe hidraulikë (gëlqere hidraulike, çimento), ngurtësim në ajër dhe ujë të lagësht.
- **Materialet e lyerjes** - bojëra, ngjyra (pigmente), vaj tharëse, ngjitës etj.
- **Bojrat** përgatiten kompozime shumëngjyrëshe: përzierjet e substancave ngjyrosëse me substanca të tjera. Bojrat përgatiten në ujë (me gëlqere, ngjitës dhe lidhës të tjerë), në vaj (vaj tharëse), llak etj. Në përputhje me këtë, kompozimet shumëngjyrëshe quhen: bojëra uji (ngjitës), vaj, smalt etj.
- **Hekur**
- **Energji elektrike**
- **Ujë per betone**
- **Karburant për makineritë**
- **Pajisje ndërtimi**
- **Makineri**

Të gjitha lëndët e para që janë përdorur gjatë fazës së përgatitjes së objektit shkolle me anekset e saj janë siguruar nga tregu vendas, sipas legjislacionit në fuqi, për operimin e ndërmarrjeve tregëtare.

Ndërsa gjatë fazës së shfrytëzimit të kompleksit lëndët e para që përdoren janë:

Boje ne rast demtimi dhe amortizimi te lyerjeve metalike

f) Informacionin për lidhjet e mundshme të projektit me projekte të tjera ekzistuese përreth/pranë zonës së projektit;

Në zonën ku ne shojme të zhvilluar e projektin ndertim ure nuk kemi projekte të tjera ekzistuese të ketij lloj. Në sipërfaqen tonë të miratuar për ndertim ure është prona e bashkise Lezhe , Per tu lidhur me projekte te tilla nuk ka jane te nevojshme .

g) Informacionin për alternativat e marra në konsideratë, për sa i takon përzgjedhjes së vendndodhjes së projektit dhe teknologjisë që do të përdoret;

Drejtuesi i bashkise Lezhe, pranon këtë zgjidhje të projektit të zhvilluar, nisur nga arsyetimet në vijim:

- Trualli është pronë e bashkise dhe nuk kerkon shpronesime;
- Trualli është lidhur me rrugë automobilistike, duke krijuar lehtësi në qarkullimin e mjeteve per nxensit, fshatareve dhe kafsheve te punes
- Ndertimi I nje ure

Bashkia Lezhe , ka objekt të aktivitetit të saj shërbime: ndertimi I ures mbi perroin e Ungrejt Sa me siper duke marre parasysh interesin publik te projektit, objektivat e zhvillimit ekonomik te vendit, planifikimin e territorit dhe detyrimeve ligjore kontraktuale për lehtësimin në ushtrimin e veprimtarisë transportit .Përzgjedhje e vendit të projektit është e përcaktuar nga prona ku zotërohet nga ana e Bashkise Teknologjia e përdorur për ndërtim dhe shfrytëzim të ures është ajo klasike gërmim –ndërtim- shfrytëzim

gj) Të dhënat për përdorimin e lëndëve të para gjatë funksionimit, përfshirë sasi të ujit të nevojshëm, të energjisë, lëndëve djegëse dhe mënyrën e sigurimit të tyre;

Per funksionimin e instalimit do te perdoren lendet e para si meposhte:

- **Sasia e ujit të nevojshëm që do të përdoret** -nuk eshte e nevojshme
- **Energjia elektrike** -nuk eshte nevojshme sepse nuk ka sistem ndricimi te ures
- **Karburant dhe lubrifikant** -nuk perdoret gjate funksjonimit te ures

h) Aktivitete të tjera që mund të nevojiten për zbatimin e projektit, si ndërtimi i kampeve apo rezidencave etj.;

Nuk nevojiten as kampe as rezidenca.

i) Infromacionin për lejet, autorizimet dhe licencat e nevojshme për projektin, në përputhje me përcaktimet e bëra në legjislacionin në fuqi, si dhe institucionet kompetente për lejimin / autorizimin/ licencimin e projektit

Për ndërtimin dhe vendosjen ne funksionim të ures është e domosdoshme që bashkia të pajiset me:

- Vendimin e VNM paraprake nga Agjensia e Kombetare e Mjedisit
- Leja e zhvillimit te ndertimit te ures mbi perroin Ungrej qe miratohet nga AZHT
- Leja e ndertimit
- Zbardhja e kësaj leje nga Bashkia Lezhe

j) Kopje të lejeve, autorizimeve dhe licencave që disponon zhvilluesi për projektin e propozuar, në përputhje me përcaktimet e bëra në legjislacionin në fuqi, si dhe institucionet kompetente për lejimin / autorizimin/licencimin e projektit.

- Bashkia Lezhë do te pajiset me lejen mjedisore për ndërtimin e urës.
- Ndërsa përsa i përket lejeve te kërkuara për ndërtimin e urës, Bashkia është duke përgatitur dokumentacionet e kërkuara sipas legjislacionit ne fuqi.

Përgatiti Raportin Teknik
Ekspert mjedisi Yzeir MIRAKA
Ing Mjedisi Elio Mehmeti



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E MJEDISIT, PYJEVE DHE ADMINISTRIMIT TË UJËRAVE

Rruga "Durrësit" Nr. 27 Tiranë. Tel. 04 224 572 Fax. 0 4 270 627 www.moe.gov.al

Nr. 224 Prot.

Tiranë, më 20.04.2006

Vendimi nr. 3, Nr. 176 Regj.

ÇERTIFIKATË

Në mbështetje të vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 268, datë 24.04.2003 "Për çertifikimin e specialistëve, për vlerësimin e ndikimit në mjedis dhe auditimin mjedisor":

Yzeir MIRAKA

Çertifikohet për hartimin e raporteve të vlerësimit të ndikimit në mjedis, për të kryer auditimin mjedisor, për hartimin e ekspertizave për probleme mjedisore dhe thirrjen si ekspert për të vlerësuar një raport të vlerësimit të ndikimit në mjedis ose rezultatet e një auditimi.

MINISTRI

L. Xhuvelli

Luftër XHUVELI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Ministria e Zhvillimit Ekonomik,
Tregtisë dhe Sipërmarrjes

LICENCË



LN-7695-03-2014	NUJS/NIPT: K61731002D
Subjekti: ZENIT - 06	
Adresa: TIRANE, TIRANE, TIRANE, Rruga "Myrteza Topi", Nd.18, Ap.38	
Kodi: III.2.A (1+2)	Kod tjetër:
Data e lëshimit: 26/03/2014	Afati i vlefshmërisë: Pa afat
Kategoria	
Shërbime ekspertize dhe/ose profesionale lidhur me ndikimin në mjedis	
Nënkategoria	
Veprimtaritë e ekspertizës lidhur me ndikimin në mjedis	
Veprimtari specifike	
1. Ndikim në mjedis 2. Auditim mjedisor	
Specialiteti	

Emërtimi përshkrues i veprimtarisë

Veprimtaritë e ekspertizës lidhur me ndikimin në mjedis (Auditim mjedisor, vlerësimi i ndikimit në mjedis)

Kufizime specifike

Licenca ushtrohet sipas kufizimeve në legjislacionin në fuqi


Detyrime specifike

Licenca ushtrohet sipas detyrimeve në legjislacionin në fuqi

Vendi i kryerjes së veprimtarisë

Në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.

Nënshtkrimi i sportelit: *Sh. m. 20*





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS

me autoritetin e tij ligjor,
me rekomandimin e
Fakultetit të Inxhinierisë së Ndërtimit

i jep Z.

Elio Bujar Mehmeti

lindur në Peshkopi, Dibër, më 26.01.1995

me ID të Maturës Shtetërore: 131939700093

Diplomë BACHELOR

në Inxhinieri Mjedisi

pas përfundimit me sukses të studimeve universitare të ciklit të parë
me kohë të plotë në programin mësimor parashikuar për këtë diplomë.

Data e lëshimit të diplomës:	02.12.2016
Data e mbrojtjes së diplomës:	07.10.2016
Numër diplome:	B-1879
Numër amze:	PO851A020029

DEKANI:

Prof.Asoc. Gëzim HASKO



REKTORI:

Prof.Dr. Andrea MALIQARI